

RAPORTI TEKNIK

PER TE GJITHA NDERHYRJET NE:

OBJEKTIN: "Projekti per zhvillimin e turizmit ne Liqenin Marinez, turizmit ne zonen turistike Seferan dhe Rehabilitimi i shtigjeve turistike qe lidh Liqenet e Rrahmanit - Marinzes ", BASHKIA BELSH.

TETOR 2020

Lista e projekteve

1. PARKIM 1 NE NDERHYRJET E LIQENIT TE MARINZES


Objektivat

Të presë vizitorët e shumtë që vijnë kryesisht me makinë dhe ti ndihmojë që të lënë automjetin e të vazhdojnë më tej më këmbë drejt ishullit të Belshit dhe zonës perreth.

Përshkrimi i Projektit

Hapësirë e sheshtë, e pashtuar dhe e hijëzuar. Nderhyja ne natyre do te jete minimale, pra percaktimi i vendeve te parkimit do te behet me peme, te cilat do te sherbejne edhe per hijezim.

Vendodhja/ Pronësi: Marinez [Ky nën - projekt është i pozicionuar në tokë publike]



a) Detaje Teknike

Dimensionet: Sipërfaqja e bazës: 1000 m². Kapacitet 80 vënde.

Nisur nga fakti që itinerari që të çon tek liqeni do të jetë për këmbësorë ky parkim do të mundësojë dhe parkimin e atumjeteve me turistë.

Punime inxhinierike: Ngjeshje dhe nivelim i terrenit. Parashikim i infrastrukturës për drenazhim dhe kullim të sipërfaqes në mënyrë që të mos mbajë ujë. Për të mos pësuar ulje është parashikuar ngjeshja e dheut do të bëhet çdo 20cm, ngjeshja e zhavorit çdo 15cm dhe ngjeshja e konglomeratit çdo 10 cm. Lind nevoja gjithashtu për ngritjen e një muri betoni për mbajtjen e shtresave të shtuara të parkimit. (Për më tepër referohuni detajit përkatës).

Bimësia: Mbjellje me pemë të larta, rrap ose lloje të tjera pemësh vendase, i të gjithë hapësirës.

Tabela Orientuese: Tabelë mesatare orientuese prej druri dhe metali që përmban informacion rreth orientimit së vendit dhe të të gjithë komponentëve të tij. Printimi/boja duhet të jetë shumë cilësore dhe rezistente ndaj shiut, diellit dhe pislëkut.

b) Siguria dhe mbrojtja e vizitorëve

Hapësirë mjaftueshëm për të parkuar në mënyrë të sigurtë.


Përdorimi i shtresës së zhavorit ndihmon në drenazh, duke ndihmuar minimizimin e rrëshkitjeve në zonë.

Lista e veprimeve që çdo vizitor duhet të ketë kujdes:


- Nuk lejohet të ndizet zjarr
- Ne kujdesemi për mjedisin, ju lutemi përdorni koshat të vendosura në zonë për të ricikluar mbeturinat tuaja.
- Mos u hutoni nga telefoni juaj celular ose kufjet.
- Mbani makinën tuaj të mbyllur, edhe nëse jeni duke nxituar.
- Shikoni dy herë për këmbësorë, biçikleta dhe automjete të tjera gjatë kohës që po parkoni.
- Drejtoni ngadalë dhe respektoni kufijtë dhe shenjat e shpejtësisë së lejuar.
- Qëndroni në korsi dhe shmangni parakalimin.
- Kontrolloni makinën tuaj para parkimit këtu, rrjedhja e lëngjeve ndotëse është e ndaluar.



Render Parkim



Plan



Detaj Shtresash Parkimi

2. MOLI NDERHYRJE NE LIQENIN E MARINZES


Objektivat

Të ndihmojë të gjithë vizitorët në zonë të shijojnë panoramën si dhe nëpërmjet teleskopit të shijojnë shumëllojshmërinë e zogjve në zonë.

Përshkrimi I projektit

Strukturë druri e vendosur mbi plinte betoni. Nisur nga fakti që është e vendosur buzë liqeni mbrojtja e kolonave të drurit të cilat do të vendosen mbi plint betoni do të bëhet me bazament hekuri deri në lartësinë ku uji nuk arrin kolonën e drurit.

Vendodhja/ Pronësi: Marinez & Seferan [Ky nën - projekt është i pozicionuar në tokë publike]



a) Detaje teknike

Plataformë druri (konstrukcion dhe dysheme druri) e vendosur mbi plinta betoni. Kjo strukturë është 32 m e gjatë dhe 5 me gjërë si dhe 2.5m e lartë në pjesën e mbuluar. Pjesërisht struktura do të jetë e mbyllur me ristela druri në mënyrë që të mos shqetësojnë specie e zogjve që ndodhen në zonë.

(Për më tepër referohuni detajit përkatës).

Figure 1 RENDER

3. PARKIM NE ZONEN E DEPOVE TE PERPUNIMIT TE DUHANIT

Objektivat


Të presë vizitorët e shumtë që vijnë kryesisht me makinë dhe t'i ndihmojë që të lënë automjetin e të vazhdojnë më tej më këmbë përgjatë Istmit.

Përshkrimi i Projektit

Hapësirë e sheshtë, e pashtuar dhe e hijëzuar mirë.

Përshkrimi Teknik

Vendodhja/ Pronësi: Seferan [Ky nën - projekt është i pozicionuar në tokë publike]



a) Detaje Teknike

Dimensionet: Sipërfaqja e bazës: 650m². Kapacitet 30 vënde.

Punime inxhinierike: Ngjeshje dhe nivelim i terrenit. Parashikim i infrastrukturës për drenazhim dhe kullim të sipërfaqes në mënyrë që të mos mbajë ujë. Për të mos pësuar ulje është parashikuar ngjeshja e dheut do të bëhet çdo 20cm, ngjeshja e zhavorit çdo 15cm dhe ngjeshja e konglomeratit çdo 10 cm. Lind nevoja gjithashtu për ngritjen e një muri betoni për mbajtjen e shtresave të shtuara të parkimit. (Për më tepër referohuni detajit përkatës).

Bimësia: Mbjellje me pemë të larta, rrap ose lloje të tjera pemësh vendase, i të gjithë hapësirës.

Tabela Orientuese: Tabelë mesatare orientuese prej druri dhe metali që përmban informacion rreth orientimit së vendit dhe të të gjithë komponentëve të tij. Printimi/boja duhet të jetë shumë cilësore dhe rezistente ndaj shiut, diellit dhe pislëkut.

b) Siguria dhe mbrojtja e vizitorëve

Hapësirë mjaftueshëm për të parkuar në mënyrë të sigurtë.

Përdorimi i shtresës së zhavorit ndihmon në drenazh, duke ndihmuar minimizimin e rrëshkitjeve në zonë.


Lista e veprimeve që çdo vizitor duhet të ketë kujdes:


- Nuk lejohet të ndizet zjarr
- Ne kujdesemi për mjedisin, ju lutemi përdorni koshat të vendosura në zonë për të ricikluar mbeturinat tuaja.
- Mos u hutoni nga telefoni juaj celular ose kufjet.
- Mbani makinën tuaj të mbyllur, edhe nëse jeni duke nxituar.
- Shikoni dy herë për këmbësorë, biçikleta dhe automjete të tjera gjatë kohës që po parkoni.
- Drejtoni ngadalë dhe respektoni kufijtë dhe shenjat e shpejtësisë së lejuar.
- Qëndroni në korsi dhe shmangni parakalimin.
- Kontrolloni makinën tuaj para parkimit këtu, rrjedhja e lëngjeve ndotëse është e ndaluar.



Render Parkim 2

PLAN Parkim





Detaj Shtrese

4. ZONË PUSHIMI PËR KAMPERA NDERHYRJE NE LIQENIN E MARINZES

Objektivat

Të presë vizitorët e shumtë që vizitojnë vendin dhe (Shqipërinë) me kamperat e tyre. Të krijojë mundësi për të qëndruar në natyrë, dhe në zonë, dhe gjatë natës.

Përshkrimi i Projektit

Hapësirë e sheshtë, e pashtuar dhe e hijëzuar mirë me shërbime minimale për përdoruesit. Përveç energjisë elektrike, nuk ofrohet asnjë shërbim tjetër. Kjo është e rëndësishme, sepse do të shmangte ndotjen dhe zhurmën që krijojnë motorët e makinave apo përdorimi i mundshëm i gjeneratorëve portabël.

Vendodhja/ Pronësi: Liqenin Marinez [Ky nën - projekt është i pozicionuar në tokë publike]



a) Detaje Teknike

Dimensionet: Sipërfaqja e bazës: 3600 m². Kapacitet 36 vënde. Si dhe 36 hapsira të gjelbërta midis për përdorim nga Kamperat.

Punime inxhinierike: Ngjeshje dhe nivelim i terrenit. Parashikim i infrastrukturës për drenazhim dhe kullim të sipërfaqes në mënyrë që të mos mbajë ujë. Për të mos pësuar ulje ngjeshja e dheut do të bëhet çdo 20cm, ngjeshja e zhavorit çdo 15cm dhe ngjeshja e konglomeratit çdo 10 cm. Lind nevoja gjithashtu për ngritjen e një muri betoni për mbajtjen e shtresave të shtuara të parkimit. (Për më tepër referohuni detajit përkatës).

Bimësia: Mbjellje me pemë të larta, rrap ose lloje të tjera pemësh vendase, i të gjithë hapësirës.

Tabela Orientuese: Tabelë mesatare orientuese prej druri dhe metali që përmban informacion rreth orientimit së vendit dhe të të gjithë komponentëve të tij. Printimi/boja duhet të jetë shumë cilësore dhe rezistente ndaj shiut, diellit dhe pislëkut.

b) Siguria dhe mbrojtja e vizitorëve

Hapësirë mjaftueshëm për të parkuar në mënyrë të sigurtë.


Përdorimi i shtresës së zhavorit ndihmon në drenazh, duke ndihmuar minimizimin e rrëshkitjeve në zonë.


Lista e veprimeve që çdo vizitor duhet të ketë kujdes:

- Nuk lejohet të ndizet zjarr kudo, me përjashtim të zgarave (3 m larg çdo gjëje që mund të marë flakë).
- Ne kujdesemi për mjedisin, ju lutemi përdorni koshat të vendosura në zonë për të ricikluar mbeturinat tuaja.
- Mos u hutoni nga telefoni juaj celular ose kufjet.
- Mbani makinën tuaj të mbyllur, edhe nëse jeni duke nxituar.
- Shikoni dy herë për këmbësorë, biçikleta dhe automjete të tjera gjatë kohës që po parkoni.
- Drejtoni ngadalë dhe respektoni kufijtë dhe shenjat e shpejtësisë së lejuar.
- Qëndroni në korsi dhe shmangni parakalimin.
- Kontrolloni makinën tuaj para parkimit këtu, rrjedhja e lëngjeve ndotëse është e ndaluar.



Render





Detaj

5. ZONË KAMPINGU PËR TENDAT NDERHYRJE NE LIQENIN E MARINZES

Objektivat


Të ofrojë për vizitorët që dëshirojnë të qëndrojnë në zonë, një vend kampimi gjatë natës, duke përdorur tenda dhe çanta shpine.

Përshkrim i Projektit

Hapësirë e sheshtë, e pashtuar dhe e hijëzuar mirë me shërbime minimale për përdoruesit. Përveç një vendi të posaçëm kampimi nuk ofrohet asnjë shërbim tjetër. Një hapësirë e thjeshtë ku të vendosen tenda të një madhësie mesatare. Brenda zonës së kampimit nuk do të parkohet asnjë makinë.

Përshkrimi Teknik

Vendodhja/ Pronësi: Liqeni Marinez [Ky nën - projekt është i pozicionuar në tokë publike]



a) Detaje Teknike

Dimensionet: Sipërfaqja e bazës: 2000m². Sipërfaqja e gropës së caktuar për çdo tendë 4x5m=20m². Krijimi i mundësisë për të prituri deri në 100 tenda. (Gjysma e hapësirave të parkimit janë caktuar në parkimin aty afër)

Punime inxhinierike: Ngjeshje dhe nivelim i terrenit. Parashikim i infrastrukturës për drenazhim dhe kullim të sipërfaqes në mënyrë që të mos mbajë ujë.

Bimësia: Mbjellje me pemë të larta, rrap ose lloje të tjera pemësh vendase, i të gjithë hapësirës.

Tabela Orientuese: Tabelë mesatare orientuese 1.5m² prej druri dhe metali që përmban informacion rreth planimetrisë së vendit dhe të të gjithë komponentëve të tij. Printimi/boja duhet të jetë shumë cilësore dhe rezistente ndaj shiut, diellit dhe pislëkut.

a) Siguria dhe mbrojtja e vizitorëve

Hapësirë mjaftueshëm për të parkuar në mënyrë të sigurtë.


Përdorimi i shtresës së zhavorit ndihmon në drenazh, duke ndihmuar minimizimin e rrëshkitjeve në zonë.

Lista e veprimeve që çdo vizitor duhet të ketë kujdes:

- Nuk lejohet të ndizet zjarr kudo, me përjashtim të zgarave (3 m larg çdo gjëje që mund të marë flakë).
- Ne kujdesemi për mjedisin, ju lutemi përdorni koshat të vendosura në zonë për të ricikluar mbeturinat tuaja.



Render



Detaj



6. ZONA E PIKNIKUT NDERHYRJE NE LIQENIN E MARINZES

Objektivat


T'i ofrojë vizitorëve që dëshirojnë të drekojnë apo të qëndrojnë një natë, një vend ku të ulen dhe të konsumojnë ushqimet e tyre.

Përshkrimi i Projektit

Hapësirë e sheshtë, e pashtuar dhe e hijëzuar mirë me shërbime minimale për përdoruesit. Përveç një tavoline dhe një stoli pranë saj nuk ofrohet asnjë shërbim tjetër. Brenda Zonës së Piknikut nuk do të parkohet asnjë makinë.

Përshkrimi Teknik

Vendodhja/ Pronësi: Liqeni Marinez [Ky nën - projekt është i pozicionuar në tokë publike]



a) Detaje Teknike

Dimensionet: Sipërfaqja e bazës: 4000m². Sipërfaqja e gropës së caktuar për çdo tavolinë 5x8m=40m². Krijimi i mundësisë për të prituri deri në 100 tavolina. (një e treta e hapësirave të parkimit është caktuar në parkimin aty afër)

Punime inxhinierike: Ngjeshje dhe nivelim i terrenit. Parashikim i infrastrukturës për drenazhim dhe kullim të sipërfaqes në mënyrë që të mos mbajë ujë.

Bimësia: Mbjellje me pemë të larta, rrap ose lloje të tjera pemësh vendase, i të gjithë hapësirës.

Tabela Orientuese: Tabelë mesatare orientuese prej druri dhe metali që përmban informacion rreth vendodhjes së vendit dhe të të gjithë komponentëve të tij. Printimi/boja duhet të jetë shumë cilësore dhe rezistente ndaj shiut, diellit dhe pislëkut.

b) Siguria dhe mbrojtja e vizitorëve

Hapësirë mjaftueshëm për të parkuar në mënyrë të sigurtë.

Përdorimi i shtresës së zhavorit ndihmon në drenazh, duke ndihmuar minimizimin e rrëshkitjeve në zonë.


Lista e veprimeve që çdo vizitor duhet të ketë kujdes:

- Nuk lejohet të ndizet zjarr kudo, me përjashtim të zgarave (3 m larg çdo gjëje që mund të marrë flakë).
- Ne kujdesemi për mjedisin, ju lutemi përdorni koshat të vendosura në zonë për të ricikluar mbeturinat tuaja.




Render

PLAN



DETAJ



7. URA NDERHYRJE NE LIQENIN E MARINZES

Objektivat:

Të lehtësojë kalimin në anën tjetër të liqenit duke bere te mundur kalimin ne zonën e shtëpizave dhe restorantit.

Përshkrimi i Projektit

Urë me shtylla betoni në të dy brigjet. Plani i lëvizjes me pllaka druri, me mbrojtëse anësore me konstrukcion druri e fiksuar te platforma e hekurit. E ngurtë dhe e gjerë mjaftueshëm për të mbajtur personat që përdorin karroca. Ura duhet të jetë sa më transparente për të shmangur shqetësimin e flukseve të levizjes së gjallesave ujore.

Vendodhja/ Pronësi: Liqenin Marinez.

PLANIMETRIA E URES ME GJATESI 90 METRA

SHKALLA 1/500



a) Detaje Teknike

Dimensionet: Gjatësia e segmentit: 90m. Gjerësia: 5m

Struktura: Strukturë metalike e brendshme e shtyllave mbajtëse. Veshje e jashtme e strukturës me fletë korteni, (metal i ndryshkur) të salduara mbi nën-strukturën: 450m². Dysheme me plane druri. Kavo çeliku që lidh shtyllat me planin mbajtës të urës. Themel betoni.

Trajtimi i Drurit: Është i preferueshëm përdorimi i drurit të përpunuar në fabrikë.

Trajtimi me Prezervues Druri dhe Vajra druri. Të kryhet një trajtim paraprak në pjesët strukturore ose elementin e drurit që është në kontakt me lagështinë e tokës ose ujin.

Nënveshja. Ajo ul cilësitë e thithjes së drurit dhe përmirëson ngjitjen e veshjes përfundimtare. Ajo duhet të bëhet para instalimit në vend.

Veshje e lyer me bojë të tejdukshme për ruajtjen e cilësive vizuale të drurit. Do të krijojë një shtresë me veshje, por do të rrisë jetëgjatësinë e materialit. Lidhjet duhet të aplikohen dhe instalohen para kësaj faze.

Tabela Orientuese: Tabelë e madhe orientuese prej druri dhe metali që përmban informacion rreth orintimit të projektit dhe të të gjithë komponentëve të tij. Printimi/boja duhet të jetë shumë cilësore dhe rezistente ndaj shiut, diellit dhe pislëkut.

a) Siguria dhe mbrojtja e vizitorëve



Struktura do të ketë themele të betonit të ngurta që japin soliditetin e strukturës, të llogaritura sipas normative shqiptare dhe euro kodeve.

Struktura mbajtëse është projektuar me strukturë metalike, është nevoja që kjo strukturë të përforcohet me stukturë metalike

Panelet metalike prej korteni do të jenë të përthyera në mënyrë që të mos bëjnë rrezik për vizitorët.

Lista e veprimeve që çdo vizitor duhet të ketë kujdes:

- Nuk lejohet ndezja e zjarrit.
- Nuk Lejohet vrapimi mbi urë.
- Nuk lejohet hedhja mbi ujë.
- Mos ndaloni mbi urë.
- Mbani fëmijët për dore gjatë kalimit mbi urë.
- Mos shkatërroni florën dhe faunën.
- Ndalohen vizitorët të futen në kanalet ujore
- Kjo urë është projektuar për kalimin e vizitorevë nëse janë në këmbë ose më biçikleta.





8. Shtigjet Turistike nga Liqeni Rrahmanit – Liqeni Merhojes me L=8KM

Pershkrimi i Pergjithshem

Zona në të cilën do të ndërtohet pista për këmbësorë dhe është një zonë kryesore për turizmin në qytetin e Belshit. Kjo rrugë lidhet me disa liqene si, Liqeni i Rrahmanit, Marinzes, Merhojes, ku në veri është Liqeni Seferan, i cili tashmë është krijuar si një vend turistik pas shumë investimeve që janë bërë në rrethinat e tij.

Krijimi i kësaj rruge do të ndihmonte gjithashtu për të çuar më tej aktivitetet përgjatë saj dhe madje do të shërbente për shpërndarjen e aktiviteteve të tjera dhe liqeneve të tjerë. Në të cilën është planifikuar një zonë plazhi në Liqenin Merhoje dhe një zonë Kamper në Liqenin e Marinez. Natyra ka qenë shumë e dashur me zonën e Belshit ku ka krijuar një numër liqenesh dhe i ka dhënë një bukuri të pafundme e cila me investimin e duhur mund të bëhet një qendër shumë tërheqëse turistike, duke kombinuar hipur në kalë, shëtitje në natyrë dhe panormën e fushave të mbjelljes të ndërthurura me të shumta pasqyrat ujore ftojnë për relaksimin e

mendjes dhe trupit. Në këtë projekt ne jemi përqendruar në aktivitetet që mund të krijohen në Liqenin Merhoje dhe Marinez. Lidhja e infrastrukturës ka qenë gjithmonë një problem i madh për turizmin, megjithëse infrastruktura rrugore në zonën e Belshit është shumë e mirë, tani është e nevojshme të kthehemi përsëri në ato aktivitete që mund të lënë makinën dhe të përqendrohen në njohjen e natyrës përmes shëtitjes, hipjes ose çiklizëm.

Aktivitetet e Planifikuara

- I. Pista e kembesoreve
- II. Vende panoramike dhe kampe me pamje nga fushat e mbjella
- III. Spote panoramike dhe kampe me pamje nga Liqeni Seferan
- IV. Kampe në Liqenin e Marinzës.
- V. Zona e plazhit në liqenin Merhojes.

NEVOJAT E RRUGES

Shtegu është i domosdoshëm sepse është lidhja lidhëse midis disa liqeneve, por edhe një aks i domosdoshëm për ndërlidhjen e aktiviteteve të planifikuara.

Shtegu i këmbësorëve ka një zhvillim prej afërsisht 8000 ml. Itinerari fillon në Liqenin e Rrahmanit, ku kalon ne rrugen kryesore Belsh – Grekan – Dragot, me pas kalon perms fshatit Idrizaj dhe perfundon midis dy liqenve me turistike te zones se Dumrese Merhojes dhe Seferanit. Gjithashtu itinerari i ketij shtegu lidhet dhe me fshatin e Merhojes ku vazhdon ne rrugen e asfaltuar e cila te con ne plazhin e ketij fshati.

SEKSIONI TIP

Për gjeometrizimin e itinerarit, është miratuar një seksion tip që përbëhet nga një pjesë e përdorur për qarkullimin e biçikletave dhe këmbësorëve në një formë të shthurur me gjerësi 4.00 m. Të dy palët kanë një pjerrësi tërthore, për të gjithë zhvillimin e projektit, e barabartë me 2.00% drejt pjesës së jashtme në mënyrë që të formojnë formën klasike "mbrapa gomarit" për të lehtësuar largimin e ujit dhe për të shmangur amullinë në platformë. Seksionet në llogore dhe argjinaturë përfshijnë të dyja një skotik prej 0.30 m i cili do të ripërdoret në fazën e ndërtimit për të mbuluar shpatet me tokë perimesh. Diferenca e djathtë dhe e majtë në argjinaturë përbëhet nga 1.25 m argjile dhe një pjerrësi me pjerrësi konstante 3/2. Ujërat e platformës hidhen duke futur hendeqe mbrojtëse në këmbët e argjinaturës me përmasa 30x30x30 cm. Në llogore, diferenca e jashtme në një lartësi më të ulët është e përbërë nga 0.50

m arginello, një hendek 30x30x30 cm për hedhjen e ujërave të platformës dhe një 0.50 m më tej arginello për të filluar më pas me një pjerrësi konstante 3/2.

SHTRESAT

Ky segment i shtigjeve është për përdorim të kembesoreve e cila do të pasqyrohet me një shtrese totale prej 25 cm.

Duke filluar nga poshtë superstruktura përbëhet nga:

- 10 cm të nenshtreses së zhavorit.
- 15 cm çakull.

PERSHKRIMI I RRUGES

Përgjatë tërë drejtëzës, platforma ka një hap të dyfishtë me një pjerrësi tërthore prej $q = 2.5\%$. Gjatë rrugës, dritat e rrugës me ndricim led të ngulitura ishin të pozicionuara në mënyrë që pista të mund të bëhej e arritshme edhe në mbrëmje. Mbillen edhe pemë frutore. Në zonat e shesheve panoramike janë planifikuar, vendet e kampeve verore, zona e lojërave për fëmijë, stola të zgjuara dhe kosha të zgjuar të plehrave.

9. Vendosja e Shtepizave & Restorantit NDERHYRJE NE LIQENIN E MARINZES

a) Shtepizat e Drurit

Ne liqenin e Marinzes jane parashikuar te pozicionohen 7 shtepiza druri dhe nje ambjent sherbimi restorant.

Shtepizat kane nje dizajn minimal alpin te cilat integrohen shume mire edhe ne territorin perreth liqenit te Marinzes. Materialet e perdorura per ndertimin e ketyre shtepizave, jane materiale drusore ekologjike, te cilat e bejn inpaktin e nderhyrjes ne natyre akoma edhe me minimal per te mos prishur ekosistemin e zones.

Shtepizat jane te konceptuara ne dy kate, ku kati perdhe perben ambjentin e ndenjes dhe kati i pare perben dhomat e ndenjes. Siperfaqja totale e nje shtepize eshte 30 m² kati perdhe & 15 m².

Shtepizat jane parashikuar te ndertohen me material drusore si meposhte:

1. Dyshemeja perbehet:

- Trare druri 15x10cm (pishe suedeze);
- Dy shtresa kompesate e impregnuar;
- Pambuk imperial me trashesi 10cm (termoizolim);
- Parket laminat.

2. Dyshemeja e katit te pare perbehet:

- Trare druri 15x10cm (pishe suedeze);
- Derrase dyshemeje trashesia 4cm (pishe suedeze).

3. Konstruksioni i godines me trare druri 15x10cm (pishe suedeze).

4. Mbulesa e catise perbehet:

- Derrase dyshemeje me zmuso 2.2cm;
- Katrama;

- Ristela 5x5cm vertikale;
 - Polisterol 5cm (me densitet te larte);
 - Ristela 4x5cm horizontale;
 - Llamarine (ngjyra jeshile);
 - Veshje e pjeses ballore llamarne (ngjyra jeshile);
5. Dritare ne planin e catise 1 cope.
 6. Muret ndarese dhe muri i jashtem i shtepise konstrukcion me trare 10x10cm, veshje me derrase pishe suedeze 2.2cm. Shtresa izoluese: pambuk mineral 10cm.
 7. Fasada ballore e shtepise me duralumin ngjyre te zeze, dopioxham termik, dera e hyrjes e inkorporuar me xham.
 8. Tualeti:
 - Dere banjo;
 - Dritare;
 - Instalime Elektrike;
 - Instalime Hidraulike;
 - Dush;
 - Lavaman;
 - Wc;
 - Xham i temperuar tek dushi
 - Pasqyre;
 9. Instalimet elektrike do te jene:
 - Te fshehur;
 - Me tuba dhe tela kunder zjarrit
 - Salvavita;
 - Ndricues 3 cope + banja;



b) Restoranti:

Restoranti ka një dizajn minimal alpin të cilat integrohen shumë mire edhe në territorin përreth liqenit të Marinzes. Materialet e përdorura për ndërtimin e këtij restoranti, janë materiale drusore ekologjike, të cilat e bëjnë inaktivin e ndërhyrjes në natyrë akoma edhe me minimal për të mos prishur ekosistemin e zonës.

Restoranti është konceptuar në një kat dhe është parashikuar të ndërtohet me materiale drusore si mëposhtë:

1. Dyshemeja përbehet:

- Trare druri 15x10cm (pishë suedeze);
- Dy shtresa kompesate e impregnuar;
- Pambuk imperial me trashësi 10cm (termoizolim);
- Parket laminat.

2. Dyshemeja e katit të parë përbehet:

- Trare druri 15x10cm (pishë suedeze);
- Derrase dyshemeje trashësia 4cm (pishë suedeze).

3. Konstruksioni i godinës me trare druri 15x10cm (pishë suedeze).

4. Mbulesa e çatisë përbehet:

- Derrase dyshemeje me zmuso 2.2cm;
- Katrama;
- Ristela 5x5cm vertikale;
- Polisterol 5cm (me densitet të lartë);
- Ristela 4x5cm horizontale;
- Lëlarinë (ngjyra jeshile);
- Veshje e pjesës balllore lëlarine (ngjyra jeshile);

5. Dritare në planin e çatisë 1 copë.

6. Muret ndarese dhe muri i jashtëm i shtëpisë konstrukcion me trare 10x10cm, veshje me derrase pishë suedeze 2.2cm. Shtresa izoluese: pambuk mineral 10cm.

7. Fasada balllore e shtëpisë me duralumin ngjyrë të zeze, dopioxham termik, dera e hyrjes e inkorporuar me xham.

8. Tualeti:


- Dere banjo;
- Dritare;
- Instalime Elektrike;
- Instalime Hidraulike;
- Dush;
- Lavaman;
- Wc;
- Xham i temperuar tek dushi
- Pasqyre;

9. Instalimet elektrike do te jene:

- Te fshehur;
- Me tuba dhe tela kunder zjarrit
- Salvavita;
- Ndricues 3 cope + banja;

Godina e restorantit perbehet nga:

- Salla e brendshme 48 m²;
- Ambjenti i gatimit 12 m²;
- Dy tualete;
- Verande 24 m² e mbuluar me cati dhe parrake druri;
- Tavoline ngrenie 100x100cm, 10 cope;
- Karrige 40 cope;
- Trashesia e pareteve te murit 16cm;
- Dera e hyrjes me dy kanate;
- Dritare ne verande.



10. Ndertim, Asfaltim i Rruges per te Depot - Seferan

1.1 - HYRJE

Fshati Seferan eshte fshate qe ndodhet ne qarkun e Elbasanit dhe pjese e njesise Administrative e Bashkise se Belshit fshati Seferen ndodhet 4 km ne jug te qytetit Belsh.

Fshatet me te afert me fshatin Seferen jane fshati Cepe,Marinez dhe fshati Hyse e Mehorje.Fshati ndodhet në një kodër të rrethuar nga 5 liqene, në të cilët rriten zambakë të verdhë dhe të bardhë duke ia shtuar bukurinë liqeneve, ndodhet në një lartësi mesatare prej 200m mbi nivelin e detit. Veçoritë klimaterike të kësaj zone janë: dimër i butë e me reshje dhe verë e nxehtë dhe e thatë.

Fshati i Seferanit ka rreth 1200 banorë, të cilët merren kryesisht me bujqësi.

Ata kultivojnë ullinj, hardhi, bëjnë verë dhe raki, por së fundmi po guxojnë pak më shumë.

Banorët atje janë ndër të parët që po merren me kultivimin e shafranit, bimë mjekësore shumë fitimprurëse, ndërkohë që po punojnë për ta kthyer zonën në një destinacion turistik shumëdimensional. Megjithatë, emigracioni mbetet burimi kryesor i të ardhurave për ta.



Fshati : Seferen

Relievi

Dumrea e parë nga lart është një pllajë e bukur, kodrinore me kodra të ulta dhe fusha të vogla, me gropa dhe me shumë liqenë të bukur natyrorë. Në përgjithësi relievi i saj dallohet nga ndryshimet e vogla të lartësive. Territorët më të larta shtrihen në formën e një brezi. Format kryesore që i japin fizionominë relievit të kësaj pllaje janë kodrat, fushë – gropat dhe gropat. Kodrat në përgjithësi dallohen për shtrirje gjatësore e tërthore të vogël dhe një pjesë e tyre janë në forma të rrumbullakta. Lartësia e zonës mbi nivelin e detit luhetet nga 100 m deri në 200m. Lartësia më e madhe e zonës është Sopi i Turres 240,2m dhe mali i Gradishtës 239m mbi nivelin e detit. Në këtë zonë ka dhe shumë gropa që janë krijuar si rezultat i fenomenit të Karstit. Ato janë shumë të përhapura në këtë zonë.

Gropa më e madhe është e ashtuquajtura “Gropa e madhe”, që ndodhet në të majtë të rrugës Fierzë-Kosovë me thellësi 80m dhe dimensione 750m x 500m. Në brendësi të zonës ka shumë hinka të tjera që janë krijuar si rrjedhojë e fenomenit të karstit. Fenomeni i karstit vazhdon dhe

sot por në përmasa të vogla (Fundosja e një sipërfaqe toke në fshatin Fierze me 12 shkurt 1998 me një volum prej 1600 m³). Shpatet e kodrave në përgjithësi janë të buta, por ka dhe shpate të pjerrta sidomos atje ku ka patur shpëputje tektonike sidomos në pjesën lindore të zonës Dumresë. Në këtë territor rrjedhin disa përrenj kryesisht në tre drejtime: Në lumin Shkumbin, Devoll dhe disa i derdhen ujrat e tyre në liqene.

Nga pikepamja gjeologjike fshati Seferan bën që të ketë një sipërfaqe të madhe toke dhe këto toka janë të pasura kryesisht me potas dhe mesatarisht me azot dhe fosfor. Tokat janë të tipit “të hirta, kafe livadhore” dhe “livadhore të hirta kafe”.

Rrjeti hidrik

Në këtë zonë ndodhen shumë liqene natyrorë si: liqeni i Belshit, Seferanit, Merhojes, Cestijes, Degës, Dorbit, Plevicës, Civiles etj. Me bukuri të rralla, me një flore të pasur siç janë zambaku i bardhë, zambaku i verdhë etj. Bukuritë e tyre kanë tërhequr vëmendjen e vizitorëve vendas dhe të huaj të cilët i kanë vlersuar si dhuratë të natyrës së kësaj zone, ku dhe shumë shkrimtarë e poetë i kanë shkruar vargje bukurive të tyre.

Fauna e liqeneve është e pasur me peshq të llojeve të ndryshme siç janë krap, amuri etj. Në disa liqene ka dhe ngjala të cilat janë specie endogjene.

Rrjeti rrugor


Rrjeti rrugor i sotëm në këtë zonë aktualisht është trajtuar me asfalt vetëm në një pjesë të saj që fillon nga rruga Seferan deri në fillim të rrufes Sheherle që është e shtruar vetëm me çakull. Rruge tjeter e trajtuar me asfalt është ajo e rruges cepe që lidhet me rrugën Kosovës (Elbasan).

Fauna dhe Flora

Bimësia e Dumresë është mjaft e varfër, me përjashtim të disa zonave të komunës Grekan, në të cilën egzistojnë akoma sipërfaqe pyjore. Drurët kryesorë që janë tipikë të kësaj zone janë pishat, kryesisht në fshatin Rrasë dhe Cerrage; plepi gjendet i shpërndarë pothuajse në të gjithë territorin si edhe shëllgu në afërsi të liqeneve. Përpara pothuajse e gjithë zona e Dumresë ishte e mbuluar nga pyjet, ku mbizotëronte druri i dushkut.

Nga vitet 1950 deri në 1970 u ndërmor një proces i gjërë i shpyllëzimit të zonës. Territori i Dumresë u ndryshua pothuajse i tëri për toka bujqësore, ndërsa sasia e drurëve të prerë u shfrytëzua për ndërtimin e hekurudhave në të gjithë vendin.

Në vitet e fundit një pjesë e mirë e territorit po rigjen gjelbërimin e munguar këtu 50 vjet pasi një pjesë e territorit po mbillet sërish me vreshta rrushi dhe ullinj.



1.2 - VEND NDODHJA E OBJEKTIT

Aksi i rruges Depo –Seferan

1.3 - GJENDJA E INFRASTRUKTURES EKZISTUESE

A.SITUATA E ZHVILLIMIT URBAN

Mbas viteve 90'si në gjithë fshaterat e shqiperise u shfaqën shënjat e para të nevojës për shfrytëzimin e tokës duke zhvilluar ndërtime private.

Ndertimet në këtë zonë jane bërë siapas nevojave të banoreve , pa asnje planifikim .



B.GJENDJA E INFRASTRUKTURES



Segmenti rrugore ka dimensione qe variojne 2.5-4.5m.

Trotuaret nuk ekzistojen ne asnjeren nga rruget



Ujesjellesi:Rrjeti i furnizimit me uje egziston ne brendesi te fshatit Seferan dhe ka nevojë për nderhyrje.

Sistemi KUZ:Per shkak se kjo rrugë nuk është e trajtuar me asfalt edhe sistemi i K.U.Z mungon , egziston ne në pjesë të veçanta të tij janë ndërtuar nga vetë komuniteti, por janë jashtë kushteve teknike.



Sistemi KUSH:Kanalizimet e ujrave te bardha ne nje pjese te segmentit eshte ne formen natyrale ku ne disa pjese te rruges ujerat kalojne neper tombino por qe kjo menyre eshte e pamjaftueshme per zgjidhje te problemit te segmentin te rruges ne fjale. Ne kohe me shi ne shume vende krijohen gropa dhe pellgje uji, te cilat perbejne nje shqetesim teper te madh per banoret. Ujrat shkarkojne ne forme natyrale, me rrjedhje te lire, sipas pjerresise se terrenit.





1.4–STUDIMI TOPOGRAFIK

Punimet Gjeodezike

Bashkia Belsh me stafin ne kete projekt te rruges Depo –Seferen ka bere projektin mbi bazen e kerkesave teknike te pergjitheshme dhe specifike te parashikuara per studimin dhe projektimin e rrugeve.

Sektori i topografise organizoi punen dhe zhvilloi punimet ne baze te pervojes se perftuar ne punimet e meparshme te kesaj natyre. Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese.

Rilevimi eshte bere ne sistemin nderkombetar me projeksionin UTM me ellipsoid WGS84. Duke patur parasysh zonen dhe ritmin e zhvillimit qe ajo ka, do te ishte me frytedhense nese do te perdorej dhe ky sistem. Me kete sistem mund te percaktohet lehtesisht kordinatat gjeodezike per cdo pike mbi siperfaqen tokesore nepermjet perdorimit te GPS.

Gjate rikonicionit ne terren u vendosen pikat e triangulacionit dhe markat e nivelimit ne pikat e fiksuara ne teren. Pikat e fiksuara ne teren u pajisen me koordinata ne projeksionin UTM ellipsoid WGS84 dhe kuota. Para fillimit te rilevimit u krye rikonicionii detajuar i terrenit, i cili sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes se punes, menyren e ndertimit te rrjetit gjeodezik, poligonometrise se rilevimit, nivelimit teknik si dhe organizimit te punes.

Fiksimi ne terren i pikave te rilevimit u krye me gozhde betonite ngulura ne objekte betoni dhe kunja hekuri. Ato jane vendosur ne vende te dukeshme dhe te pa levizeshme. Identiteti i tyre eshte fiksuar me boje te kuqe te shkruajtur ne afersi te pikes fikse ne vende te dukeshme nga rruga ekzistuese ose terreni. Ato jane vendosur ne vende te qendrueshme, ne ane te rruges ose afer saj, duke siguruar ne kete menyre lidhjen dhe vazhdimesine e punes nga faza e projektimit ne ate te zbatimit te tij.

Çdo pike e fiksuar ne terren ka numrin, koordinatat te saj, si dhe lartesine te perftuar nepermjet nivelimit gjeometrik e gjeodezik (shih planimetrite e objekteve ku gjenden koordinatat tre dimensionale te pikave mbeshtetese). Keto te dhena sigurojne gjetjen e tyre me lehtesi ne terren.

Pikat fikse te terrenit jane te percaktuara ne planimetrine e segmenteve rrugore qe perfshihen ne projekt.

Matjet u kryen me GPS Trimble, Stacion Total Topcon



Rilevimi

Duke u mbështetur në pikat e poligonometrise u zhvillua procesi i matjeve topografike

Është rilevuar në mënyrë të plotë e gjithë sipërfaqja e zonës ku shtrihet objekti si dhe e një brezi perimetral që e qarkon atë. Në reliev janë pasqyruar në mënyrë të plotë të tërë elementet përberës të tij, kanale, puseta, platforma betoni, shtylla ndricimi ose tensioni, bunkere, tombino, trotuare, ura, ndërtesa, objekte të ndryshme, rrugë kryesore e dytesore, perrenj, një numër i dendur pikash detaje etj. Punimet topogjeodezike të kryera janë mbështetur në shkallën e plotë të përgatitjes profesionale, në përdorimin e teknologjive bashkëkohore për matjet fushore dhe përpunimin kompjuterik e të dhënave, për të plotësuar kërkesat teknike të parashtruara nga projektuesit. Çdo pikë e marrë në terren ka koordinata tre dimensionale, të paraqitura në projekt.

Përpunimi i materialit topografik në zyrë është bërë me programin TBC (Trimble Business Center), CIVIL 3D nga ku është përfutur relievi tre dimensional i objektit. Ky reliev shërbeu për hartimin e projektit të zbatimit me saktësi dhe cilësi të kërkuar në termat e referencës nga investitori.

Në materialin grafik të projektit jepet planimetria e pikave poligonale dhe tabela e koordinatave të pikave të vendosura në terren.

2. - ZGJIDHJA E PROJEKTIT

2.1 –Projekti i “Rehabilitimi i Rruga per te Depo -Seferan” Bashkia Belsh

Objekti “Rehabilitimi i rrugeve -Rruga per te Depo Seferan”, ndodhet në pjesen jugore te qytetit te Belshit me nje largesi prej 4km

Rruga paraqeset rëndësi për lëvizjen e banorëve të zonës ku shtrihet rruga, gjithashtu edhe rrjeti i kanalizimeve ne keto zona eshte i domosdoshem.

“Rehabilitimi i rrugeve -Rruga per te Depo Seferan”, me gjatesi totale rreth 725ml, kanë gjeresi ekzistuese e cila varion nga 2.5ml deri në 4.5 ml, duke sjelle karakteristika gjeometrike ne plan jo te rregullta. Ne altimetri, segmenti rrugor ka pjerresi te theksuar qe varion 5-10 %.

Rruga, eshte teresish ne gjendje te keqe dhe me mungese te shtresave rrugore.

Duke u mbeshtetur ne studimin per prespektiven e zhvillimit te zones, eshte dhene zgjidhje:

1-Ne realizimin e nje rruge me gjeresi 4m asfalt ,

2-Kunete ne te dy anet e rruges me gjersi prej 50cm .

3-Tortuar ne njeran ane te rruges me gjeresi 1m dhe gjatesi prej 725ml ,

4- Kanal ne te gjithe aksin e rruges me nje gjersi prej 50cm.

5-Ndricim ne krahun e djathte te rruges pergjat gjithe gjatesise se rruges

Meqënëse i gjithe segmentit rikonstruktohen terësisht, në zgjidhjen e projektit janë patur parasysh:

1. Zgjidhja në anën Planimetrike të rrugës.
2. Zgjidhja në anën Altimetrike të rrugës.
3. Elementet sociale të rrugës.

■ Zgjidhja Planimetrike.

Në zgjidhjen Planimetrike është patur parasysh permisimi i dhe dhe shmangia e disa kthesave duke ndikuar në gjeometrin e rruges dhe duke e permisuar atë.

Rëndësi i është kushtuar veçanërisht dhe intersektimeve të rrugëve dytësore që krijojnë kryqzime me aksin kryesor. Të gjithë kryqëzimet si kryesore ashtu dhe dytësore, është bërë rakordimi i kthesave me rreze maksimale të mundshme në funksion të objekteve kufizues.

■ Zgjidhja Altimetrike.

Nga ana altimetrike relievi faktik është shumë i thyer, duke sjellë që nivelet e saj të peshojnë thyerje sipas gjendjes faktike të relievit.

Meqenëse segmenti rrugor ndërtohet pothuajse tërësisht e para nga ana e tij është munduar të ndërtojmë një nivel të sa më pranë asaj ideale, por duke respektuar edhe kuotat e hyrjeve të objekteve ekzistuese. Gjithashtu është bërë rakordimi në kuotë me rrugën ekzistuese.

■ Profili Gjatësor

Profili gjatësor përfaqëson prerjen e rrugës sipas aksit të saj në drejtimin vertikal.

Profili gjatësor është hartuar në shkallë Horizontale 1:1000 dhe shkallë Vertikale 1:500.

Në të janë paraqitur:

- ✚ Vija e Terrenit
- ✚ Vija e Projektit
- ✚ Vija e Gjurmimit
- ✚ Disnivelet e Vijës së Projektit
- ✚ Disnivelet e Vijës së Gjurmimit
- ✚ Numri i Piketës (Seksionit)
- ✚ Kuota e Terrenit
- ✚ Kuota e Projektit
- ✚ Kuota e Gjurmimit

- ✚ Distanca Pjesore
- ✚ Distanca Progressive
- ✚ Kryqëzimet
- ✚ Pjerrësitë e Niveletës
- ✚ Kilometrazhi

■ **Profilat Tërthorë**

Profilat tërthorë përfaqësojnë prerje të rrugës tërthor me aksin e saj në drejtimin vertikal. Profilat tërthorë janë hartuar në shkallë 1:100 (e njëjtë për dy drejtimet Vertikal dhe Horizontal)

Në profilat Tërthorë janë paraqitur:

- ✚ Numri i Profilatit
- ✚ Distanca Progressive
- ✚ Sipërfaqja në Mbushje dhe Gërmim
- ✚ Vija e Terrenit
- ✚ Vija e Projektit
- ✚ Vija e Gërmimit
- ✚ Disnivelet e Vijës së Projektit
- ✚ Disnivelet e Vijës së Gërmimit
- ✚ Numri i Piketës (Seksionit)
- ✚ Kuotat e Terrenit
- ✚ Kuotat e Projektit
- ✚ Kuotat e Gërmimit
- ✚ Distancat pjesore nga Aksi
- ✚ Distanca e përgjithshme nga Aksi.

■ **Profilat Tip dhe Detajet**

Në Profilat Tip, janë paraqitur në mënyrë të detajuar:

- ✚ Shtresat Rrugore
- ✚ Dimensionet e tyre
- ✚ Vendosja e tyre
- ✚ Distanca
- ✚ Zona ku aplikohet Profili Tip

✚ Pozicioni i rrjeteve te tjera inxhinierikë.

Llogaritja e Shtresave të Rrugës


Nisur nga eksperinca ne projektimin e rrugeve, studimi i trafikut te zones dhe prespektiven e zhvillimit, studimi gjeologjik, vleresimi i gjendjes aktuale, rezulton se ne keto pjese te rrjetit rrugor, jane te destinuara kryesisht per mjete te tonazhit te lehte dhe te mesem.

Rruga rrugore do te germohej teresisht ne forme kasonete.

Shtresat Rrugore

Shtresat Rrugore të dala nga llogaritjet dhe të diktuar për riaritur nivelin mesatar të rrugës në lidhje me terrenin, do të jenë:

Per rruget kryesore te bllokut:



Asfaltobeton	- 4 cm
Binder	- 6 cm
Stabilizant	- 15 cm
Çakëll makinerie	- 20 cm

■ Në trupin e rrugës kasoneta pas gërmimit duhet detyrimisht të cilindrohet. Nëse gjatë gërmimit në ndonjë pjesë nuk arrihet heqja plotësisht e shtresës së sipërme, (vërehet ndryshimi i formacionit), në atë pjesë të vazhdojë gërmimi, dhe të mbushet me zhavorr. Gjithashtu gërmimi do vazhdoje edhe nese ne trup te rruges gjendet ndonjë kanal apo gropë septike e vjetër.

Gjatë realizimit të shtresave, detyrimisht të respektohet cilësia e materialeve dhe kërkesat për kompaktësim, në përputhje me specifikimet teknike.

KONKLUSIONE

Projekt Studimi “Rehabilitimi i rrugeve -Rruga per te Depo Seferan”është hartuar në përputhje me kërkesat e termave të references te Bashkise Belsh .


Në zgjidhjen e projektit, duke patur parasysh edhe shtrirjen e këtij objekti dhe numrin e banoreve te fshaterave qe pershkron kjo rruge është patur qëllim kryesor qe kjo rruge te trajtohet me asfalt dhe elementet e tjere te nje rruge qe tju vijne ne ndihme banoreve te fshatit Seferen dhe banoreve te fshatrave per rreth por edhe banoreve qe vijne per te vizituar kete zone te bukur me liqenet e shumta qe jane.

Ne te gjithë teresine e rruges duke pare edhe fluksin e kalimit te makinave por dhe buxhetit te dhene nga Bashkia Belsh eshte menduar qe rruga te kete nje gjeresi perj 4m me asfalt .

Realizimi i ndertimit te kesaj rruge do te lehtesoje qarkullimin e mjeteve te transportit per banoret e ketyre fshatrave por do kete edhe impakt pozitiv si mjedisor qe ndikon duke ulur ndjeshem ne cileesine e ajrit por dhe impakt pozitiv social-ekonomik pasi prodhimet e e banoreve te fshatrave transportohen me mire dhe me sigurt ne rruge me asfalt.

Kryerja e investimit nga Bashkia Belsh, ne kete zone është bërë aktualisht një domosdoshmëri, dhe do ketë një efekt të menjehershëm në ndryshimin e menyrës dhe cilësisë së jetesës së banorevë.

11. Ndertimi i Depove, fshati Seferan, Belsh





ZGJIDHJA KONSTRUKTIVE

Eshte bere mbi bazen e studimit gjeologjik per nje objekt me nje kate, shih pershkrimet e meposhtme.

Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse janë njësi metrike të shprehur në mm, cm, m, m², m³, Km, N (Njuton), Mg (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “.”.

Godina eshte llogaritur duke u bazuar ne KTP shqiptare perfshire KTP 2/89 per normat antisizmike si dhe ne Eurokodet 2 dhe 8 . Per llogaritjen e struktures eshte perdorur program automatik i llogaritjes i tipit STA4CAD 12 i licensuar ne normat e Komunitetit Europjan per llogaritje ne zona sizmike.

Ne llogaritje skema eshte konsideruar 3 dimensionale dhe jane pasur parasysh ngarkesat vetjake ,mbingarkesat,ngarkesat sizmike dhe diference temperature prej 15 grade Celsius ne strukture.

Struktura eshte konsideruar mikse me kolona elastike dhe me mure b/a dhe diafragma.

Intensiteti sizmik eshte llogaritur 8 balle akseleracioni($a_g=0,25g$)

Mbingarkesat per ambjentet e banimit jane konsideruar 300 kg/m² ,per ballkonet 300 kg/m² ,per dyqanet dhe ambjentet e sherbimit ne katin perdhe 400 kg/m²,ndersa per pjesen ku kalon rruga 1000 kg/m².

Materialet e perdorura te jene

-Betonet Rck=300 per pllaken b/a te themelit, kolona mure b/a te mbistruktures dhe te bodrumit ,traret dhe soletat,shkallat.

-Celiku qe do perdoret te jete i tipit FeB44K ose Sidenor S500 S

-Materiali mbushes i soletave 25 cm te jete tulle solete me lartesi 20 cm e lehtesur ose me deshire te investitorit polisteron ,ne rastin e perdorimit te polisteronit para vendosjes se tij te vendoset nje rrjete teli 2x2 cm per suvatim.

-Tulla e perdorur te jete e tipit te lehtesuar 10 cm per muret e brendshme. Ne muraturen e tulates te realizohen breza lidhes ne kuotat e arkitrareve te dyrve dhe dritareve si dhe per muret e jashtme pervec tij edhe nen kuoten e dritareve.

Muratura te realizohet me llac bastard M30 .

KOLONAT DHE MURET B/A TE MBISTRUKTURES

Realizohen me beton me Rck 300 kg/cm² dhe me hekur FeB44 K ose Sidenor S500 S

Te kihet kujdes ne ruajtjen e vertikalitetit te kolonave dhe mureve brenda kushteve teknike pasi deformime te mureve apo kolonave do te sjellnin gjendje tensionale shtese ne te gjithë objektin te paparashikuara keto ne fazen e projektimit.

Gjuntimet e hekurit te realizohen me saldim ose me lidhje sipas projektit ,te respektohen shpeshtimet e stafave prane nyjeve te tejkalimit te nderkateve sipas projektit.

Vibrimi I betonit te realizohet me vibrator.

Kujdes i vecante ti kushtohet stafes sipas paraqitjes grafike ne projekt ku ganxhat te kthehen me kende 45 grade dhe 135 grade nga brenda seksionit .

Ne kolona dhe mure ne nivelet e arkitraut te dritareve dhe dyerve dhe poshte dritareve lihen fitila hekur 10 mm per lidhjen e brezave a/s te muratures.

BETONET

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR BETONET HARTIMIM PROJEKTIMIT PER BETONET

Betoni është një përzierje e çimentos, inerte të fraksionuara të rërës, inerte të fraksionuara të zhavorit dhe ujit dhe solucioneve të ndryshme për fortësinë, përshkueshmërinë e ujit dhe për të bërë të mundur që të punohet edhe në temperatura të ulëta sipas kërkesave dhe nevojave teknike të projektit.

MATERIALET

PËRBËRËSIT E BETONIT

Përbërësit e betonit duhet të përmbajnë rërë të larë ose granil, ose përzierje të të dyjave si dhe gurë të thyer. Të gjithë agregatët duhet të jenë pastruar nga mbeturinat organike si dhe nga dheu. Pjesa kryesore e agregateve duhet të jetë me formë këndore dhe jo të rrumbullakët. Përbërësit e betonit duhet të kenë certifikatën që vërteton vendin ku janë marrë ato.

ÇIMENTO

Kontraktuesi është i detyruar që për çdo ngarkesë çimentoje të prurë në objekt, të paraqesë faturën e blerjes e cila të përmbajë: sasinë, emrin e prodhuesit si dhe certifikatën e prodhuesit dhe shërben për të treguar që çimentoja e secilës ngarkesë është e kontrolluar dhe me analiza sipas standarteve.

Për më shumë detaje në lidhje me markën e çimentos që duhet përdorur në prodhimin e betoneve, shiko në pikën 4.1.4, pasi për marka betoni të ndryshme duhen përdorur marka çimento të ndryshme.

UJI PËR BETON

Uji që do të përdoret në prodhimin e betonit duhet të jetë I pastër nga substancat që dëmtojnë atë si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe substanca të tjera organike. Në përgjithësi, uji i tubacioneve të furnizimit të popullsisë (uji i pijshëm) rekomandohet për përdorim në prodhimin e betonit.

DEPOZITIMI I MATERIALEVE

Depozitimi i materialeve që do të përdoren për prodhimin e betonit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

Çimentoja dhe përbërësit duhet të depozitohen në atë mënyrë që të ruhen nga përzierja me materiale të tjera, të cilat nuk janë të përshtatshme për prodhimin e betonit dhe e dëmtojnë cilësinë e tij.

Çimentoja duhet të depozitohet në ambiente pa lagështirë dhe që nuk lejojnë lagjen e saj nga uji dhe shirat.

KLASIFIKIMI I BETONEVE

3.1.3.1 Beton marka 100, me zhavor natyror: Çimento marka 300, 240 kg; zhavorr 1,05 m³; ujë 0,19 m³.

3.1.3.2 Beton marka 100 me inerte, konsistencë 3 – 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 300, 240 kg; rërë e larë 0,45 m³; granil 0,70 m³; ujë 0,19 m³.

3.1.3.3 3.1.4.3 Beton marka 150 me inerte, konsistencë 3 – 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 400, 260 kg, rërë e larë 0,44 m³, granil 0,70 m³, ujë 0,18 m³.

3.1.3.4 Beton marka 200 me inerte, konsistencë 3 – 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 400, 300 kg, rërë e larë 0,43 m³, granil 0,69 m³, ujë 0,18 m³.

3.1.3.5 Beton marka 250 me inerte, konsistencë 3 – 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 400, 370 kg, rërë e larë 0,43 m³, granil 0,69 m³, ujë 0,18 m³.

3.1.3.6 Beton marka 300 me inerte, konsistencë 3 – 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 400, 465 kg, rërë e larë 0,38 m³, granil 0,64 m³, ujë 0,195 m³.

MATERIALET

Përgatitja e çelikut për të gjitha strukturat e betonit dhe komponentët e metalit, që duhen prodhuar në kantier, duke konsideruar çelikun që plotëson të gjitha kërkesat e projektit dhe pa prezencën e ndryshkut, në format dhe përmasat sipas vizatimeve dhe standarteve tekniko-legale për bashkimin, lidhjen dhe duke e shoqëruar me certifikatën e prodhuesit për të verifikuar që çeliku plotëson kushtet e kërkuara që nevojiten për punë të tilla dhe duke përfshirë të gjitha kërkesat e tjera jo të specifikuar.

DEPOZITIMI NË KANTIER

Depozitimi i hekurit në kantier duhet të bëhet i tillë, që të mos dëmtohet (shtrëmbërohet, pasi kjo gjë do të shtonte procesin e punës së paranderjes) si dhe të mos pengojë punimet ose materialet e tjera të ndërtimit

KTHIMI I HEKURIT

Hekurat duhen kthyer sipas dimensioneve të treguara në projekt.

Përveç pjesës së lejuar më poshtë, të gjitha shufrat duhen kthyer dhe kthimi duhet bërë ngadalë, drejt dhe pa ushtrim force. Bashkimet e nxehta nuk lejohen.

Prerja me oksigjen e shufrave shumë të tendosshme do të lejohet vetëm me aprovimin e Supervizorit. Shufrat e ambllazhimit nuk mund të drejtohen dhe të përdoren.

VENDOSJA DHE FIKSIMI

Hekurat do të pozicionohen siç janë paraqitur në projekt dhe do të ruajnë këtë pozicion edhe gjatë betonimeve. Për të siguruar pozicionin e projektit ata lidhen me tel 1,25 mm ose kapëse të përshtatshme.

MBULIMI I HEKURIT

Termi mbulimi në këtë rast do të thotë minimumin e pastër të shtresës mbrojtëse ndërmjet sipërfaqes së hekurave dhe faqes së betonit.

Mbulimi minimal do të bëhet sipas normave të KTZ dhe shënimeve në projekt.

SALDIMI I HEKURAVE

Saldimi ose bashkimi i shufrave të hekurit do të bëhet vetëm sipas vizatimeve të treguara të aprovuara nga Investitori.

Gjatësia e mbivendosjes në një lidhje, nuk duhet të jetë më e vogël se ajo e treguara në vizatimet e punës apo rekomandimeve sipas normave të KTZ.